



Rregullorja e Bordit të Platformës CiviKos

Prishtinë, 04 Prill 2014

Roli dhe Përgjegjësitë e Bordit të Platformës CiviKos

Bordi do të veprojë në pajtim me frymën dhe politikat e Platformës CiviKos (*më poshtë CiviKos*) dhe do të angazhohet në arritjen e qëllimeve të CiviKos të përcaktuara me Statut.

1. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit dhe mandati i tyre

- 1.1 Bordi i CiviKos zgjidhet nga Kuvendi i Anëtarëve, me shumicë votash, dhe përbëhet nga së paku 5 anëtarë. Për mundësinë e rritjes së numrit të anëtarëve të Bordit të CiviKos vendos Kuvendi i Anëtarëve.
- 1.2 Mandati i anëtarëve të Bordit të CiviKos është dyvjeçar dhe trevjeçar, me mundësi rizgjedhjeje. 50% + 1 të anëtarëve të Bordit që fitojnë më së shumti vota në Kuvendin e Anëtarëve zgjedhen me mandat trevjeçar, ndërsa pjesa tjetër e anëtarëve të Bordit zgjedhen me mandat dyvjeçar.
- 1.3 Anëtarët e Bordit të CiviKos duhet të jenë anëtarë të organizatave anëtare të CiviKos, të jenë të pavarur politikisht, të dëshmuar për promovimin e vlerave demokratike dhe avancimin e shoqërisë civile dhe të kenë të paktën përvojë 5 vjeçare në sektorin e shoqërisë civile në Kosovë.
- 1.4 Propozimin për anëtarë të Bordit të CiviKos mund ta bëjnë organizatat anëtare dhe Bordi i CiviKos, duke i'u përmbajtur kritereve të përcaktuara në nenin 1.3 të kësaj Rregulloreje.
- 1.5 Mandati i anëtarit të Bordit të CiviKos përfundon:
 - 1.5.1 Në rast të dorëheqjes vullnetare të tij/saj;
 - 1.5.2 Në rast të shkeljes së rëndë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij/saj si anëtar i Bordit të CiviKos, me vendim të Kuvendit të Anëtarëve;
 - 1.5.3 Në rast të largimit nga organizata anëtare e CiviKos, anëtar i së cilës ka qenë gjatë periudhës së zgjedhjes si anëtar i Bordit të CiviKos, përveç në rastet kur vazhdon të mbetet anëtar i një organizatë tjetër anëtare të CiviKos;
 - 1.5.4 Në rast të mospjesëmarrjes në takimet e Bordit të CiviKos për një vit me rradhë.

2. Takimet e Bordit

- 2.1 Në takimin e tij të parë pas zgjedhjes së anëtarëve të rinj, Bordi do të zgjedhë Kryetarin njërin nga anëtarët e tij, me mandat dyvjeçar. Lejohet rizgjedhja e kryetarit të Bordit.
- 2.2 Kryetari i Bordit duhet të thërrasë takime të Bordit sipas nevojës, por të paktën katër (4) herë brenda një viti. Bordi duhet të pajtohet për një orar të përkohshëm të takimeve të paktën dy javë para takimit. Materialet për takim duhet të dërgohen te të gjithë anëtarët e Bordit, të paktën një javë para takimit, nga Kryetari i Bordit, Drejtori Ekzekutiv ose Sekretariati i CiviKos.

- 2.3 Takimet e Bordit mund të thirren gjithashtu edhe nga të paktën tre (3) anëtarë të Bordit.
- 2.4 Në takimet e Bordit, përveç anëtarëve të Bordit merr pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv. Sipas nevojës, Kryetari i Bordit ose të paktën tre (3) anëtarë mund të ftojnë në takim edhe persona tjerë prania e të cilëve konsiderohet e domosdoshme për mbarëvajtjen e takimit.
- 2.5 Drejtori Ekzekutiv, ose një nga punëtorët e Sekretariatit, mbajnë procesverbalin e takimit, i cili i shpërndahet anëtarëve të Bordit jo më vonë se një (1) javë pas takimit, dhe i cili nënshkruhet nga Kryetari i Bordit jo më vonë se në takimin e rradhës, pas aprovimit nga Bordi.
- 2.6 Shumica e anëtarëve të Bordit do të përbëjnë kuorumin. Nëse nuk ka kuorum, mbledhja do të shtyhet për ditën e caktuar, por jo më vonë se dy (2) javë pas datës fillestare të paraparë për takim, dhe njoftimi do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve paraprakisht.

3. Kompetencat

Bordi i CiviKos ka kompetenca për:

- 3.1 Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të CiviKos dhe përcaktimin e detyrave të tij/saj;
- 3.2 Përcaktimin e numrit të të punësuarëve në Sekretariatit e CiviKos;
- 3.3 Aprovimin fillestar të planit të punës, planifikimit vjetor buxhetor, raporteve narrative dhe atyre financiare, dhe propozimin e tyre në Kuvend;
- 3.4 Aprovimin e granteve dhe donacioneve për CiviKos;
- 3.5 Përfaqësimin e CiviKos me palë të treta dhe diskutimet e marrëveshjeve potenciale të CiviKos me këto palë;
- 3.6 Nënshkrimin e marrëveshjeve me palë të treta, pas marrjes së pëlqimit nga Kuvendi;
- 3.7 Pranimin e anëtarëve të rinjë të CiviKos, pas vlerësimit që i plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara me Statut;
- 3.8 Përcaktimin e datës së mbajtjes së Kuvendit dhe rendit të ditës, pas konsultimit me organizatat anëtare;
- 3.9 Propozimin e ndryshimeve në Statut, Kod Etik, Rregullore të Punës, Rregullore të Bordit apo dokumente tjera të CiviKos të cilat duhet të aprovohen nga Kuvendi;
- 3.10 Emërimin e grupeve sektoriale të përhershme ose grupeve punuese të përkohshme dhe përcaktimin e mandatit dhe kompetencave të tyre.
- 3.11 Diskutimin e të gjitha çështjeve tjera me rëndësi për CiviKos;

4. Vendim-marrja

- 4.1 Vendimet e Bordit synohet të mirren me konsensus. Në rastet e mospajtimeve ose në rastet specifike të parapara me akte tjera të CiviKos, vendimet mirren me shumicë të thjeshtë të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit. Në rast të rezultatit të barabartë të votimit, Kryetari i Bordit do të ketë votën vendimtare. Vendimet e Bordit janë të vlefshme nëse janë të pranishëm shumica e thjeshtë e anëtarëve të Bordit.
- 4.2 Secili anëtar i Bordit duhet të përmbahet nga votimi në të gjitha rastet kur ai/ajo ose organizata anëtar/e i/e së cilës është ka interes ekonomik. Secili anëtar i Bordit duhet që paraprakisht të deklarojë konfliktin e interesit për çështjen e cila diskutohet dhe e cila hidhet në votim.

5. Gjuha e punës

- 5.1 Gjuha e punës së Bordit është gjuha shqipe, ndërsa sipas nevojës mund të përdoret edhe ajo serbe apo angleze.

6. Kompenzimi

- 6.1 Në parim, puna e anëtarëve të Bordit të CiviKos do të bëhet në mënyrë vullnetare.
- 6.2 Përjashtimisht nga neni 6.1, me vendim të posaqëm të Bordit, anëtarët e Bordit do të kompenzohen me një mëditje të caktuar e cila nuk guxon ta kalojë shumën prej 100 Euro për takim, dhe atë vetëm në rastet kur CiviKos posedon me fonde të mjaftueshme për këtë pagesë.
- 6.3 Përjashtimisht nga neni 6.1, pagesa e anëtarëve të Bordit të CiviKos lejohet vetëm në rastet kur një angazhim shtesë i veçantë kërkohet nga ndonjë anëtar i Bordit, dhe vetëm pasi që Bordi të ketë ardhur në përfundim që ky angazhim është i domosdoshëm dhe bëhet në kushtet më të favorshme për CiviKos.